

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rikthehet Celine Dion, ikona e muzikës performon live përballë fansave në Paris pas më shumë se gjashtë vitesh
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/13/rikthehet-celine-dion-ikona-e-muzikes-performon-live-perball-e-fansave-ne-paris-pas-me-shume-se-gjashte-vitesh654654/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 07:14:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	13 shtator 2026, 06:41:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 13 shtator 2026, 06:40:00 UTC → 13 shtator 2026, 06:42:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	68a046457f0599c82d2988e77fbfc6ae70bf513a400ab6d32def28f8b2e2564c
TEKSTI	3510fbdcc15a020fb9599a9e49a947b53961bcbbc4f7ed2fea18717d108b747b
PAMJA	6d14bcf6dbdbfea1a565c55691cac14dd4d4f91744fd5ec7a2cec748432a879c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	26c62a505cecddec5430f4526f4ac2410b477eff1ab17fe75751f71e77559dfac
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a57398cf8eb56e5c3824c7ad1d9738b2b29a5a5940aff90c94875084de23f115
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/26c62a505cecddec5430f4526f4ac2410b477eff1ab17fe75751f71e77559dfac>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

Rikthehet Celine Dion, ikona e muzikës performon live përballë fansave në Paris pas më shumë se gjashtë vitesh

13/09/2026 08:41



Céline Dion është rikthyer në skenë në Paris, ku u përlot gjatë performancës së saj të parë live pas më shumë se gjashtë vitesh, pas një periudhe të gjatë tërheqjeje nga aktiviteti muzikor për shkak të problemeve shëndetësore.

Përpara publikut, në një sallë të tejmbushur, këngëtarja kanadeze, dukshëm e emocionuar, u tha fansave se ishte "e mahnitshme që jemi të gjithë bashkë".

"Unë bëra një premtim. Bëra një premtim se do të kthehesha dhe do të isha sërish në skenë. Ja ku jam, duke kënduar për ju dhe duke kënduar për veten time. Ju falënderoj shumë për mbështetjen dhe durimin tuaj. Unë jam gjithçka që jam sepse ju më doni", tha Dion.

Performanca e fundit e plotë e këngëtares ishte në vitin 2020, si pjesë e turneut "Courage". Ajo u detyrua të anulonte pjesën e planifikuar të turneut në Amerikën e Veriut në vitin 2022, pasi u diagnostikua me SPS (Stiff Person Syndrome).

SPS është një çrregullim i rrallë neurologjik autoimun, i cili shkakton shpesh ngurtësi të muskujve dhe spazma të dhimbshme, me simptoma që ndryshojnë në intensitet. Sëmundja shkaktohet nga një reagim i gabuar i sistemit imunitar, i cili sulmon qelizat nervore të shëndetshme. Aktualisht, nuk ka një kurë të njohur për këtë gjendje.

Pas diagnozës, Dion u tërhoq nga skena dhe gjatë viteve të fundit është shfaqur vetëm në disa raste të veçanta. Ajo performoi në një event virtual bamirësie për punonjësit e shëndetësisë gjatë pandemisë së COVID-19 në vitin 2020, në ceremoninë e hapjes së Lojërave Olimpikë të Parisit në vitin 2024, ku këndoi këngën "Hymne à l'amour" të Édith Piaf, si dhe në përfundim të sfilatës së stilistit Elie Saab në Riad të Arabisë Saudite, po atë vit.

Koncerti në Paris shënon nisjen e një serie prej 26 shfaqjesh që Dion pritet të zhvillojë në "Plénitude Arena", që do të zgjasë nga 12 shtatori 2026 deri më 29 maj 2027.

Numri i koncerteve u rrit nga 10 në 26 për shkak të kërkesës së lartë për bileta. Sipas raportimeve, rreth 1.17 milionë bileta u shitën brenda pak orësh nga dalja në shitje, ndërsa më shumë se 9 milionë fansa tentuan t'i blinin ato.

Gjatë koncerteve, Dion pritet të interpretojë disa nga hitet e saj më të njohura, përfshirë baladën "My Heart Will Go On", fituese e çmimeve Oscar dhe Grammy, si dhe këngë të tjera në anglisht dhe në frëngjisht, gjuhën e saj amtare, mes tyre "It's All Coming Back to Me Now", "The Power of Love" dhe "Pour que tu m'aimes encore".

Rikthimi në skenë shënon një moment të rëndësishëm për këngëtares 58-vjeçare, e cila prej vitesh është përballur me një sëmundje të rrallë, ndërsa vazhdon karrierën e saj muzikore përballë një prej sfidave më të mëdha shëndetësore të jetës së saj.

Kryesore



SPAK sërish para Kuvendit për masë sigurie ndaj Ballukut? Akuzat e reja ndaj ish-zv. kryeministres rikthejnë debatin për një kërkesë të dytë në Parlament

19:54

"E duan rritjen që nga prilli 2023"/ Rama për vendimin e Gjykatës Administrative: "Prapambetjet" e pagave për gjyqtarët shkojnë në 130.5 milionë euro

16:04

U arrestua në Greqi si kreu i bandës së kokainës, kush është "i tmerrshmi i Beratit", saga e krimeve që akuzohet në Shqipëri dhe arratisjet nga burgu

21:33

Ambulanca përplas të moshuarin në Korçë, shoferi ishte i dehur e çon vetë në spital

09:27

Tritol banesës së mësuesit në Shkodër, zbulohet emri i pronarit të shtëpisë

22:22

Më të lexuarat

Nuk ka "fund" droga e sekuestruar e "të tmerrshmit të Beratit", gjenden edhe 26 kg kokainë në banesën e Lulëzim Cakës, vendi ku e fshihte

U dhunua shtatzënë gjatë grabitjes, humbi fëmijën, 9 vite burg për "trurin" e sulmit ndaj Donnarummës dhe partneres së tij

Vdekja e Mazonakis/ Ngrihet alarmi nga mjekët, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë alternative, informohuni për...

U arrestua në Greqi si kreu i bandës së kokainës, kush është "i tmerrshmi i Beratit", saga e krimeve që akuzohet në Shqipëri dhe arratisjet nga burgu

Vuçiq ndryshon 'pllakë' për Thačin: Në Paris mora "sinjale të ndryshme" për vendimin ndaj tij

Mësuesit në Shkodër i hodhën tritol në banesë, dyshohet se autorët 'paralajmëruan' vëllanë e tij, zbardhen emrat

SPAK sërish para Kuvendit për masë sigurie ndaj Ballukut? Akuzat e reja ndaj ish-zv. kryeministres rikthejnë debatin për një kërkesë të dytë në Parlament

U arratis nga spitali grek, zbulohen fotot e të dënuarit Gentian Çipit, ja si duket ai sot

Harta e re Territoriale, Rama nga Vlora:

Bota »



Po kalonte nëpër Ngushticën e Hormuzit, goditet nga një raketë një anije e panjohur

13/09 08:25



Kriza me emigracionin në Ceuta/ Autoritetet spanjolle publikojnë shifrat, 13 mijë të bllokuar, 2 mijë prej tyre të mitur

12/09 22:57



Dehje më e shpejtë? Temperaturat e larta ndikojnë edhe te shampanja, autoritete franceze autorizojnë prodhimin e saj me përqindje më të lartë alkooli

12/09 22:49



Vdekja e Mazonakis/ Ngrihet alarmi nga mjekët, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë alternative, informohuni për...

12/09 21:30



Panik në Bruksel/ Droni i panjohur pikaset në hapësirën ajrore të aeroportit të kryeqytetit belg, ndërpriten uljet dhe ngritjet për 30 minuta

12/09 21:25



Tragjedi në Kili, azili i të moshuarve përfshihet nga flakët, humbin jetën 16 persona

12/09 19:15

Kryesore »



Po kalonte nëpër Ngushticën e Hormuzit, goditet nga një raketë një anije e panjohur

13/09 08:25



Kushte të paqëndrueshme dhe vranësira të herëpashershme, parashikimi i motit për këtë të dielë

13/09 08:10



Mësuesit në Shkodër i hodhën tritol në banesë, dyshohet se autorët 'paralajmëruan' vëllanë e tij, zbardhen emrat

12/09 22:36



Harta e re Territoriale, Rama nga Vlora: Bashkimi do bëhet, e thotë historia dhe numrat

12/09 22:31



Tritol banesës së mësuesit në Shkodër, zbulohet emri i pronarit të shtëpisë

12/09 22:22



Nuk ka "fund" droga e sekuestruar e "të tmerrshmit të Beratit", gjenden edhe 26 kg kokainë në banesën e Lulëzimit Cakës, vendi ku e fshihte

12/09 22:12

Na ndiqni:



Video »



Bashkimi do bëhet, e thotë historia dhe numrat

U kap në Greqi, shqiptari misterioz i kërkuar për vrasje jetonte në vilën luksoze në Marathona, i gjenden 2 kg kokainë dhe armë në banesë

Top Channel/ Jepet alarmi për Al: Më e rrezikshme nga sa e mendojmë



Top Channel/ Kapet në Greqi vrasësi shqiptar, "koka" e kokainës në trëndafila

Top Channel/ Protesta rrethon Kryeministrinë, policia zbret në shesh



Top Channel/ Berisha vjen nga SHBA: Udhëtimi ripërtëritës i jetë sime!

Top Channel/ Harta e re, Rama i prerë: Bashkim do bëhet, mbyllet brenda 2031



Top Channel/ Vdekja e Mazonakis, mjeku ngrë alarmin, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë për...

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Bileta
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.